

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GRUPIMI QYTETAR KUNDËR PROJEKTIT "TID DURRËS" DHE AVOKATI PËRFAQËSUES I DISA PREJ PRONARËVE DHE BANORËVE TË PREKUR

Nr. ____ prot.
Durrës, më 28.08.2026

DREJTUAR:

1. **Bashkisë Durrës**
Në vëmendje të Kryetarit të Bashkisë;
2. **Ministrit të Kulturës**
Në vëmendje të Ministrit;
Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore – IKTK;
Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale – KKTKM;
3. **Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit – KKTU**
Nëpërmjet Sekretariatit Teknik pranë AKPT-së;
4. **Agjencisë së Zhvillimit të Territorit – AZHT.**

PËR DIJENI:

1. Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit – AKPT;
2. Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim – AADF;
3. Ministrit të Ekonomisë;
4. Avokatit të Popullit.
5. **Gjyqtarës Ema Shaholli**
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë
Çështja gjyqësore nr. 80897-06036, Akti, datë 16.10.2025.

LËNDA:

Kërkesë për informacion dhe sqarim institucional mbi pasojat e VKM-së nr. 621, datë 30.7.2026, për projektin "TID Durrës", si dhe kërkesë për pezullimin e zbatimit dhe fillimin e procedurave për anulimin e plotë të projektit

Kërkesë për informacion/ sqarim institucional mbi pasojat e VKM-së nr. 621, datë 30.7.2026, për projektin "TID Durrës".

Të nderuar,

Ne, **Grupimi Qytetar kundër Projektit "TID Durrës"**, së bashku me **avokatin përfaqësues të pronarëve të disa nga banorët e prekur**, në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", ligjit nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", Kodit të Procedurave Administrative dhe legjislacionit për njoftimin dhe konsultimin publik, ju drejtohem me këtë kërkesë për informacion, sqarim dhe marrjen e masave institucionale përkatëse.

Kërkesa lidhet me hyrjen në fuqi të **Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 621, datë 30.7.2026**, të botuar në **Fletoren Zyrtare nr. 171/2026**, me të cilin është shfuqizuar VKM-ja nr. 442, datë 3.6.2020, "Për shpalljen e zonës së re për zhvillim, në Njësinë Administrative Durrës, Bashkia Durrës, dhe caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si njësi zbatuese".

VKM-ja nr. 442, datë 3.6.2020, ka shërbyer si akt bazë për shpalljen e Zonës 5 në Durrës si zonë e re për zhvillim dhe, më pas, për hartimin dhe miratimin, me **Vendimin nr. 39, datë 19.5.2021**, të Planit të Detyruar Vendor për Zonën e Re për Zhvillim, Zona 5, Bashkia Durrës.

Shfuqizimi i këtij akti ndryshon bazën territoriale dhe juridike mbi të cilën janë mbështetur vendimmarrjet e mëvonshme, përfshirë projektin:


"Restaurimi dhe Rikualifikimi Urban i Zonës Perspektive TID, Parku Arkeologjik Durrës".

Sipas dokumentacionit të administruar dhe krahasimit paraprak të gjurmës së projektit, nga **74 pronat e parashikuara për shpronësim**, rezulton se rreth **20 prona nuk duhet të jenë më objekt prishjeje apo ndërhyrjeje**, si pasojë e shfuqizimit të aktit që lidhej me zhvillimin e detyruar të Zonës 5.

Ky ndryshim prek në mënyrë thelbësore gjurmën, përmbajtjen, funksionimin, fizibilitetin dhe justifikimin e projektit. Një projekt që humbet një pjesë të konsiderueshme të pronave dhe objekteve mbi të cilat është hartuar nuk mund të vazhdojë të zbatohet në të njëjtën formë, pa një rivlerësim të plotë juridik, urbanistik, arkitektonik, financiar dhe të ndikimit mbi trashëgiminë kulturore.

Për këto arsye, kërkojmë informacion dhe sqarim të plotë për çështjet e mëposhtme:

Kërkesë për informacion/ sqarim institucional mbi pasojat e VKM-së nr. 621, datë 30.7.2026, për projektin "TID Durrës".



I. MBI STATUSIN E PLANIT TË DETYRUAR VENDOR

Meqenëse VKM-ja nr. 442, datë 3.6.2020, si dhe Vendimi nr. 39, datë 19.5.2021, për miratimin e Planit të Detyruar Vendor për Zonën e Re për Zhvillim, Zona 5, Bashkia Durrës, janë shfuqizuar dhe ky fakt është bërë publik, kërkojmë të na informoni:

1. A është përditësuar në Regjistrin e Integruar të Territorit statusi juridik, planifikues dhe hartografik i Zonës 5, në përputhje me shfuqizimin e akteve të sipërpërmendura?
2. Cilat janë efektet juridike, planifikuese dhe administrative të shfuqizimit të PDyV-së Durrës, Zona 5, mbi projektet, lejet dhe procedurat e miratuara ose të nisura mbi bazën e këtij plani?
3. Cilat janë efektet konkrete të shënimit të publikuar nga AKPT-ja, sipas të cilit **"PDyV Durrës, Zona 5" rezulton i shfuqizuar?**
4. A janë njoftuar zyrtarisht institucionet përgjegjëse dhe subjektet e përfshira për shfuqizimin e këtij plani dhe për pasojat që ai sjell mbi procedurat dhe projektet në zhvillim?

II. MBI PASOJAT PËR PROJEKTIN "TID DURRËS"

6. Si do të reflektohet VKM-ja nr. 621, datë 30.7.2026, në gjurmën, programin, projektin teknik dhe zbatimin e projektit "TID Durrës"?
7. Cilat prona dhe objekte të përfshira në projekt nuk do të preken më nga prishja, shpronësimi apo ndërhyrjet ndërtimore?
8. Si mund të vazhdojë projekti në formën e miratuar, kur një pjesë e konsiderueshme e pronave dhe objekteve mbi të cilat është hartuar nuk rezultojnë më pjesë e së njëjtës ndërhyrje?
9. A është kërkuar ose miratuar ndryshimi i projektit fillestar, i lejes së zhvillimit, i lejes së ndërtimit apo i akteve të tjera administrative që lidhen me projektin?
10. A është kryer një rivlerësim i projektit, duke qenë se gjurma dhe përmbajtja e tij kanë ndryshuar në mënyrë thelbësore?

III. MBI AKTET E TRASHËGIMISË KULTURORE

13. Si do të ndikojë shfuqizimi i VKM-së nr. 442, datë 3.6.2020, në Vendimin nr. 461, datë 16.9.2022, të KKTKM-së, dhe a do të fillojë procedura për rishqyrtimin, ndryshimin, pezullimin ose shfuqizimin e tij, në përputhje me gjendjen e re juridike dhe territoriale të projektit? A ka përgatitur IKTK-ja një vlerësim të ri mbi ndikimin që ndryshimi i gjurmës së projektit sjell për Parkun Arkeologjik të

Kërkesë për informacion/ sqarim institucional mbi pasojat e VKM-së nr. 621, datë 30.7.2026, për projektin "TID Durrës".



- Durrësit, Amfiteatrin, strukturën historike urbane dhe objektet me vlera të trashëgimisë kulturore?
14. Si do të rishikohet vlefshmëria e miratimit të dhënë nga organet e trashëgimisë kulturore, duke qenë se projekti i shqyrtuar dhe miratuar nuk përputhet më me gjendjen e re juridike dhe territoriale?
 15. Si do të procedohet për paraqitjen dhe shqyrtimin e një projekti të ri ose për rivlerësimin e plotë të projektit ekzistues nga organet përgjegjëse për trashëgiminë kulturore?
 16. Si do të organizohet një procedurë e re konsultimi dhe vlerësimi për ndikimin e projektit mbi trashëgiminë arkeologjike, kulturore dhe urbane të Durrësit?


IV. MBI LEJET DHE AKTET ADMINISTRATIVE

19. Cili është statusi aktual juridik dhe administrativ i:
 - Vendimit nr. 39, datë 19.5.2021, për Planin e Detyruar Vendor;
 - Vendimit nr. 461, datë 16.9.2022, të KKTKM-së;
 - Vendimit nr. 07, datë 2.4.2024, të KKTU-së;
 - VKM-së nr. 477, datë 31.7.2025, për shpronësimin;
 - lejes së Bashkisë Durrës nr. 1167-25/3, datë 24.12.2025;
 - çdo lejeje tjetër zhvillimi, ndërtimi, prishjeje apo ndërhyrjeje të lëshuar për projektin "TID Durrës"?
20. Si do t'i nënshtrohen këto akte procedurës së rishikimit, ndryshimit, pezullimit ose anulimit, pas ndryshimit të bazës territoriale dhe planifikuese?
21. Çfarë urdhri, vendimi ose akti administrativ është nxjerrë apo parashikohet të nxirret për pezullimin e përkohshëm të projektit?
22. Si dhe kur janë njoftuar zyrtarisht institucionet dhe subjektet e përfshira për pasojat e VKM-së nr. 621, datë 30.7.2026, dhe çfarë masash u është kërkuar të marrin?

V. MBI SHPRONËSIMET DHE PRONAT E PREKURA

23. Si ndikon shfuqizimi i VKM-së nr. 442, datë 3.6.2020, në VKM-në nr. 477, datë 31.7.2025, dhe në procedurat e shpronësimit të 74 pronave?
24. A do të hiqen nga lista e shpronësimit pronat që nuk preken më nga projekti ose që ndodhen në pjesën e territorit për të cilën është shfuqizuar baza e zhvillimit të detyruar?

Kërkesë për informacion/ sqarim institucional mbi pasojat e VKM-së nr. 621, datë 30.7.2026, për projektin "TID Durrës".



25. A janë pezulluar njoftimet, vlerësimet, pagesat, procedurat e kalimit të pronësisë, lejet e prishjes dhe çdo veprim tjetër administrativ ndaj të gjithë pronarëve prekur nga projekti TID?
26. Kur dhe në çfarë forme do të njoftohet individualisht secili pronar për statusin e ri të pronës së tij?
27. A do të ndryshohet ose shfuqizohet pjesërisht VKM-ja nr. 477, datë 31.7.2025, për pronat që nuk rezultojnë më të nevojshme për realizimin e projektit?

VI. MBI ROLIN DHE FINANCIMIN E AADF-së

28. A është njoftuar zyrtarisht Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim – AADF për pasojat që sjell VKM-ja nr. 621, datë 30.7.2026?
29. A janë pezulluar nga AADF-ja financimi, procedurat e prokurimit, kontratat dhe çdo veprim tjetër që lidhet me zbatimin e projektit?
30. A ekziston një vendimmarrje ose korrespondencë ndërmjet Bashkisë Durrës, Ministrisë së Kulturës, IKTK-së, KKTKM-së, KKTU-së, AZHT-së, AKPT-së dhe AADF-së lidhur me vijimin, ndryshimin apo pezullimin e projektit?

VII. KËRKESAT PËR MARRJEN E MASAVE

Deri në përfundimin e rivlerësimit juridik, teknik, financiar dhe të trashëgimisë kulturore, si dhe deri në dhënien e një përgjigjeje të plotë institucionale, kërkojmë:

1. **Pezullimin e menjëhershëm të zbatimit të projektit "TID Durrës" në të gjithë gjurmën e tij;**
2. Pezullimin e çdo procedure shpronësimi, prishjeje, ndërhyrjeje fizike, financimi, prokurimi, kontraktimi ose zbatimi;
3. Pezullimin e çdo veprimi administrativ ndaj pronarëve dhe banorëve të prekur;
4. Rishqyrtimin e plotë të të gjitha akteve, vendimeve dhe lejeve të lidhura me projektin;
5. Rishqyrtimin nga KKTKM-ja të Vendimit nr. 461, datë 16.9.2022;
6. Përditësimin e listës së pronave, hartës së ndërhyrjes dhe gjurmës së projektit;
7. Njoftimin individual të çdo pronari mbi statusin e pronës së tij dhe mbi vazhdimin ose ndërprerjen e procedurës së shpronësimit;
8. Zhvillimin e një procesi të ri dhe transparent konsultimi publik me pronarët, banorët, ekspertët, grupimet qytetare dhe institucionet përgjegjëse për trashëgiminë kulturore;
9. Fillimin e procedurave administrative dhe ligjore për **anulimin e plotë të projektit "TID Durrës"**, nëse konstatohet se ndryshimi i bazës territoriale,

Kërkesë për informacion/ sqarim institucional mbi pasojat e VKM-së nr. 621, datë 30.7.2026, për projektin "TID Durrës".



gjurmës dhe përmbajtjes së tij e bën të pamundur ose të paligjshëm vijimin e projektit në formën e miratuar.

VIII. DOKUMENTACIONI I KËRKUAR

Kërkojmë të na vihet në dispozicion, në format elektronik:

1. Dokumentacioni i plotë mbi pasojat juridike dhe territoriale të VKM-së nr. 621, datë 30.7.2026;
2. Harta e përditësuar e Zonës 5 dhe e gjurmës së projektit "TID Durrës";
3. Lista e përditësuar e pronave dhe objekteve të prekura;
4. Lista e pronave që nuk rezultojnë më objekt prishjeje ose shpronësimi;
5. Korrespondenca institucionale e zhvilluar pas miratimit të VKM-së nr. 621, datë 30.7.2026;
6. Çdo vendim, urdhër, opinion ose analizë për vijimin, ndryshimin, pezullimin apo anulimin e projektit.

Kërkojmë që përgjigjja të mos kufizohet në informacion të përgjithshëm, por të përmbajë, për secilën çështje:

- qëndrimin zyrtar të institucionit;
- bazën konkrete ligjore;
- aktin ose dokumentin mbështetës;
- masat e marra ose të planifikuara;
- institucionin përgjegjës;
- afatin e parashikuar për zbatimin e masave.

Kërkojmë që informacioni dhe dokumentacioni të na vihen në dispozicion brenda afateve të përcaktuara nga ligji nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", në adresën elektronike:

Nëse një pjesë e informacionit ose dokumentacionit nuk administrohet nga institucioni të cilit i drejtohet kjo kërkesë, kërkojmë që ajo t'i përcillet institucionit kompetent dhe të njoftohemi për këtë procedurë.

Shfuqizimi i VKM-së nr. 442, datë 3.6.2020, nuk mund të trajtohet si një ndryshim formal pa pasoja. Ai prek bazën territoriale dhe juridike mbi të cilën janë mbështetur vendimmarrjet e mëvonshme dhe kërkon rivlerësimin e plotë të projektit "TID Durrës".

Kur bie një pjesë thelbësore e bazës dhe e gjurmës së një projekti, ai nuk mund të vazhdojë sikur asgjë nuk ka ndryshuar.

Kërkesë për informacion/ sqarim institucional mbi pasojat e VKM-së nr. 621, datë 30.7.2026, për projektin "TID Durrës".

Përfaqësues të pronarëve dhe banorëve:

1. ARMANDO RRIJA H5
2. Evamthi Llagi I 2612
3. Marsida Kozazi I 553190
4. Helena Bruja K 95
5. Giorgia Bruja K 705
6. DENIS Llagi i 10
7. Skënder Llagi F 06
8. Suzana Llagi F 7
9. Leonida Llagi 145
10. Telesfor Ullme
11. Berlinda Cergj J 34
12. Brunilda Cergj J 360

Kërkesë për informacion/ sqarim institucional mbi pasojat e vkm-se nr. 021, date 30.7.2026, për projektin "TID Durrës".



13. Gani Kozazi
14. Marieta Kozazi №
15. Sepreso Broholli №
16. Kadrie Doka № D
17. Klitor Doka № H
18. Jajran Vjapi № e
19. Robert Vjapi № F
20. Florinda Xhogu №
21. ARTAN XHOGU №
22. Flentor Nishani №
23. Amela Nishani №
24. Kudrete Vajë № F

Kërkesë për informacion/ sqarim institucional mbi paso,
projektin "TID Durrës".





25. Oncole Veqe Nr. I 6

26. ARTUR VELJA Nr. I

27. Jay Tolizi' Ne F

28. Makbule Tolizi' Ne G

29. Anjon Ushinor Ne G

30. Isa Tjhe Nr. I 91

31. Edmond Balla H 007 260

32. Sem Balla K 603 270

33. Oneta Balla H 96 130

34. Moemi Balla K 057 25

35. Atlije Velja E 157 011

36. Ilir Vepja H 1043

Kërkesë për informacion/ sqarim institucional mbi pasojat e projektit "TID Durrës".

[Signature]

37. Elda Kacani No.

38. Arbi Velja K6022204

39. Irma Velja I 15107052

40. Alba Velja K 4561106:

41. A/lin XHoxh A2040801

42. Behtme XHoxh A9601301

43. Alena XHoxh K154058

44. Marsida XHoxh K 45016

45. Enver Mulaj H6040

46. Bresilda Sebash I3582

47. Shava Kacani F5:

48. Eugen Simoku T012296

Kërkesë për informacion/ sqarim institucional mbi pasojat
projektin "TID Durrës".

Coel

49. Redi Mema ID: I90

50. Merita Topi G159030

51. Nezohet Tepshi F16

52. Lulzim Tepshi E608

53. Roald Tepshi H91213

54. Nazmic Iscani F15413

55. Kujtim Canky F90623

56. Kelvin Canky 2

57. Ingrid Canky

58. Surane Canky

59. Kristaq Cuni F4

60. Klevi's Cuni 19

Kërkesë për informacion/ sqarim institucional mbi pasojat e
projektin "TID Durrës".

datë 30.7.2026, për

61. Kreola Dishq Nr. 1

62. Azben Dishq - Nr. 4202

63. ENI Dishq Nr. K661170

64. Ajli's Dishq - Nr. K952

65. Dolore Berloj G 551

AVOKATI PËRFAQËSUES

Av. Lazar Tunj

Nr. licence: 0283

Nënshkrimi dhe vula:

Adresa: Lqj. Nr. 2 Rr. "H. Gega" Nr. 13

E-mail:

Telefon: 0695822783

ARIL. LIRB. EMBELA KOTHA

BASHKËLIDHUR:

1. Vendimi nr. 39, datë 19.5.2021, për miratimin e Planit të Detyruar Vendor për Zonën e Re për Zhvillim, Zona 5, Bashkia Durrës:
<https://planifikimi.gov.al/index.php?eID=dumpFile&t=f&f=6645&token=f07af41fcc08b6d3095285aeebef1fbbf258a61e>
2. VKM nr. 621, datë 30.7.2026, për shfuqizimin e VKM-së nr. 442, datë 3.6.2020:
<https://planifikimi.gov.al/index.php?eID=dumpFile&t=f&f=9083&token=89e0ec5087dd9381bbc16f9a82de4360048d2a1c>
3. Kopje e Fletore Zyrtare nr. 171/2026;
4. Materiali hartografik krahasues dhe lista paraprake e pronave që nuk rezultojnë më objekt prishjeje, nëse disponohen.

Kërkesë për informacion/ sqarim institucional mbi pasojat e VKM-së nr. 621, datë 30.7.2026, për projektin "TID Durrës".

61. Kreola Disha №1

62. Azben Disha - № 4202

63. Eni Disha № K661170

64. Ajla's Disha - № K952

65. Dolore Berloj G 551

AVOKATI PËRFAQËSUES

Av. Lazar Tuni

Nr. licence: 0283

Nënshkrimi dhe vula:

Adresa: Lqj. Nr. 2 Rr. "H. Goga" Nr. 13

E-mail:

Telefon: 06 95 822 783

ARIL LIRB. ETUELA KOTIA

BASHKËLIDHUR:

1. Vendimi nr. 39, datë 19.5.2021, për miratimin e Planit të Detyruar Vendor për Zonën e Re për Zhvillim, Zona 5, Bashkia Durrës:
<https://planifikimi.gov.al/index.php?eID=dumpFile&t=f&f=6645&token=f07af41fcc08b6d3095285aeebef1fbbf258a61e>
2. VKM nr. 621, datë 30.7.2026, për shfuqizimin e VKM-së nr. 442, datë 3.6.2020:
<https://planifikimi.gov.al/index.php?eID=dumpFile&t=f&f=9083&token=89e0ec5087dd9381bbc16f9a82de4360048d2a1c>
3. Kopje e Fletores Zyrtare nr. 171/2026;
4. Materiali hartografik krahasues dhe lista paraprake e pronave që nuk rezultojnë më objekt prishjeje, nëse disponohen.

Kërkesë për informacion/ sqarim institucional mbi pasojat e VKM-së nr. 621, datë 30.7.2026, për projektin "TID Durrës".



- Kyrgyzstan**

Web page

[illegible]

